



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Praherë - Princijera MëDano	B-06-2024		
Nr. i organizit Ora/broj	Numiri/Sroj	Shticë Prilog	Vlera Vlerësuar
02 - 035/02			881

Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28 / 15, Qershori 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S È

Etoheni të merrni pjesë në mbledhjen e VI të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **21.06.2024 (e Premte)**, në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Konferencave në objektit e vjetër të komunës së Vitisë.  
Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

### R e n d d i t e

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizen Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2025-2027.
- Propozimi për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2023 në vitin 2024.
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin-ndryshim të vendimit Nr. 01-110/05-670, të datës 30.04.2024 për aprovimin për bartjen e mjeteve nga një projektë në projektet tjera në shumë prej (148.376,16) Euro
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e vendimit me nr. 01-060/01-116 të datës 01.02.2024 për këmbimin e pronës së palujtëshme komunale me pronat e palujtshme në pronësi të pronarëve Kadri (Bislim) Emërrllahu dhe Agron (Ahmet) Ahmeti.
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025.

Viti, më 13.06.2024

Me respekt!  
Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### NGA MBLEDHJA E PESTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **22.05.2024 (e mërkurë)** në zyrën e konferencave të objektit të vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Ilir Zuka, z.Ramadan Deliu, znj.Zejnepe Osmani, znj.Majlinda Shabani, znj.Zyrafete Rama, mungoj z.Jakup Demiri. Morën pjesë edhe drejtoret e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 6 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Përvendetje për nënëkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, përfaqësuesi i OSBE-së! Mirë se keni ardhur në mbledhjen e pestë të rregullt të KPF-së për këtë vit. Kemi pranuar konfirmimin e disa akteve, pjesa e bartësve të mjeteve është në rregull. Para se me hi në rend të ditës, hapi diskutim jashtë rendit të ditës.

**z.Ilir Zuka:** Përvendetje të nderuar të pranishem! Dje kemi qenë në vizitë tek shkolla në Pozharan. Kam pritë me qenë Jakupi këtu, sepse me një farë mënyre më ka akuzu mua për diçka të padrejtë edhe tani kompania e cila e ka marr tenderin për ndërtimin e shkolles në Pozharan kanë kaluar dy muaj, e një kaci nuk e ka qit hala. Unë nuk e di qysh e banë gati shkollën me e lëshu me 1 shtator. A ka për qëllim me e mbylli shkollën e mesme apo çfarë qëllimi e ka nuk e di. Dje kemi qenë së bashku me kolegen, Zyrën edhe drejtoreshën e kemi vizitu shkollën. Shkolla është në qat gjendje qysh ka qenë vjet e parvejt, aty sa punu asgjë. Një here kanë fillu dy tre punëtor kur e ka shpall tenderin ministria, d.m.th fillimish e ka vlerësu punën me sa mujmë me përfundu, e kanë qitë një vlerë dikun 98 mijë euro, edhe kur ka hi kompania që e ka fitu tenderin u kanë me 78 mijë euro. Edhe çka ka ba tash, shkon kompania bën kërkësë në ministri që nuk mundem me i fillu punimet se, me këtë shumë nuk mundem me e kry. Plus e ka kërkë një shtesë prej 10% të shumës së asaj. Kjo nuk ndodhë. Kërkun në botë nuk ndodh kjo, pasi ta fiton tenderin me kërkë. Këtë nuk fillon me punu, sespe me këtë shume që e kam marr tenderin nuk i mbuloj shpenzimet, a ata të tjerët që kanë apliku, që kanë qenë vlerë reale ashtu që si e ka parapa ministria, e nga kjo po pësojmë ne Pozherani. Mua më kanë akuzu në Kuvend e në KPF, e dini ju tash kush me e marr përgjegjësinë për këtë. Ne si Pozharan jemi lidh, e kerkoj një përgjigje për në kuvend nga Majlinda, ku ka mbet autostrata, pse nuk është përfundu autostrada, pse po lujnë me ndjenjat e qytetarëve të Komunës së Vitisë? Çdo projekt, jo vetëm këto, edhe qeveritë e kalume njëjtë. Çka po jav merr mendja atyre, çka është Vitia? Drejtori i kulturës së bashku me kryetarin e qon një kerkese në ministri për memorandum për stadiumin e Pozharanit. Përgjigja e ministrit është e pamendar mirë. Ka thanë ta presim njëhere çka po ban gjykata me KF "Vllazninë". Ti këtë stadium je tu e maru për klub. A banë gara në ligën e parë apo në ligën e pestë, ti e ki obligim, sepse ne jemi taksapagues të Komunës së Vitisë. E i njëjti ministër e ka blloku federatën e futbollit, për tri vite nuk na ka dhanë asnjë cent, sepse nuk e ka licencu federatën ministria. KF "Vllaznia" e Pozharanit ka traditë edhe asnjëhere nuk i kemi ndërpren garat. Garat janë ndërpren me 3 mars 1998 kur ka kërsitë në Prekaz, qathere kemi pushu një vit e asnjë here nuk kemi pushu as nuk kemi me pushu. Majlindë, po të lutem merre një përgjigje prej dy deputetëve edhe me mu përgigj në Kuvend. E dimi mënyrën si është nënshkru kontratra për ndërtimin e shkollës ka urdhëru ministri, sot ka me u nënshkru kontrata edhe u nënshkru, e pse nuk po e urdhëron

qat kompram qe nje ja mire punon tene nje u kry nje i shtator tene nje i qe mirevesat ne shkollat kai temaja shkojnë me fjet unë shkoj e marr djalin tim prej shkollës, sepse në ora 20:30 e kry shkollen.

**Znj.Majlinda Shabani:** Pëershendetje! Po merr kontest politik kjo çështje, nuk po ipet informimi i drejt tek shkolla e pozharanit, tek qështja e autostrades, memorandumit nuk mundem me i marr per gjigjet e tuat nese nuk dalin nga institucioni nuk mundem me ju besu fjaleve tua në këtë rast ka than ky ashtu e ai nëse ke dëshmi me ofru për at që e ki pa atëhere mujmë me besu, përndryshe tek çështja e momerandumeve se nuk po du me hi mandje në kahje politike, e dim përkrahjen që e ka bë kjo ministri si asnijëherë më parë, po jan disa procese të cilat nuk muj me kalu as edhe njëherë tjetër. Unë atë që e shof shkolla e Pozharanit, autostrada edhe gjithçka çka ndërlidhet me qytetarët e Komunës së Vitisë. Është shumë më rëndesi me u zgjidh edhe shkolla e Pozharanit, është njëra prej shkollave me e para po thamë krejt Historinë e Kosovës që ka ndodhë rasti i till e natyrish që kjo sa mirë po ne duhet me e analizu prej fillimit e deri në mbarim e mu bë realist, ta shofim si është gjendja prej fillimit. Unë e kuptoj situatën në të cilën gjendesh ti, po ndodhta ti tu insistu kaq shumë edhe qasja e jote, ndoshta ti duhesh me e ndryshu qasjen, përndryshe është ka kthehet ne aspekt negativ. Sa i përket çështjes së autostrades, është adresu kjo në Prishtinë edhe përgjigjen ke me marr në seancë. Edhe tek shkolla e Pozharanit ke me marr per gjigje, po edhe komuna ka qenë dashur me e mednu një opson tjetër për me ba zgjidhje për ata nxënësa, se tek e fundit nxënësi nuk duhet me e vujt pasojen për faj të ministrisë e të komunës. Ka qenë dashur me u afro një apsion B, sepse një gjeneratë po pëson komplekt. Aty nuk ka mesim.

**z.Illir Zuka:** Majlindë, që dy muaj u nënshkru kontrata, pse nuk është punu. Nuk po e kërkoj prej Majlindës përgjigjen, se kjo është e njëjtë si unë, po pasi punon aty edhe i përket subjektit politik nëpermjet deputetëve të Parlamentit të Kosovës me e marr një përgjigje edhe me naj sjellë në Kuvend.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Pëershendetje të nderuar të pranishme! Tri çështje që shumë here ndoshta edhe diskutimet e miaj në raport me këshilltarët kanë mujt me u diskutu kur kam thanë se në radh të parë çështja e njohjes së kompetencës ekzekutive të veten po edhe këshilltarët e kuvendit komunal të veten, janë do çështje për të cilët në Kuvendin Komunal të Vitisë kemi leju me bisedu edhe për çështje që nuk janë kanë në kompetencë tonë, është çështja e autostradës. Duhet me qenë shumë korrekt. Më fal që po të drejtohem përfaqesuese në këtë rast e LVV-së. Një çështje duhet me pas të kjart. Shumë kemi bë zhurmë në radh të parë rrëth kyqjes. Kemi pas një vendim i cili nuk është realizu, tash është rezlizu e po zhagitet që nuk bëhet. Unë e di që ki problem me marr informacion ti. Tek shkolla në vitin 2016 gurthemelimi ku në vitin 2017 kanë fillu punimet deri në vitin. 2021 është punu ngapak ju e dini edhe gjendjen e juaj çka keni bë tu e ngritë këtë çështje, po zhagitet. Vetëm 2021-2024 nuk keni qitë asnijë gozhë. Këtë duhet me e pranu, faji juaj është, ju jeni tu qeverisë, nuk jam unë tu qeverisë, sikurse ti që më fajson në nivel komunal, duhesh me pranu, por tash a jemi ne përgjegjës me lypë ne llogari për qeverinë e Republikës së Kosovës jo. A jemi ata që duhet me ngritë si temë, po, se e prekë drejtpërdrejt interesin e fëmijëve tanë dhe qytetarëve tanë. Unë kam shumë takime, ju kam tregu juve, ka qenë problem me më pranu edhe kur më kanë pranu në takim nuk më ka pritë ministresha e ka pru shefin e kabinetit dhe kam qenë shumë korrekt, ka qenë dhe Naim Pira dhe dy drejtoreshat. Inxhinierat e nderum më kanë thanë, nënkyetar e ke marrë problemin prej bishtit, dhe ju thashë jo prej bishtit, por bashë në kokë, se jam prej fillimit në ngjarje, këtë duhet me kuptu, gjithmonë kam qenë, edhe kur ka qenë minister Arsim Bajrami, nga korrektsia dhe profesionalizmi i tij nuk ka dashtë me u marrë me të, ja kam dërgu adminisratës publike, por paret kanë qenë të ndame në kuadër të minisrisë. Ky ka thanë unë do të merrem me zhvillim të procesit edukativo arsimor, por çështjen e kësaj po ja kalojmë një ministrie tjeter dhe një njeri që të jep diçka ka të drejtë me të lypë llogari dhe gjithëherë këtu e shofë atë mosgadishmérinë e Ministrisë së Arsimit. Tash më lypë ku mi ke lanë paret e mia se e ka plotësishat atë të drejtë, se kanë qenë të ndame për këtë dhe procesi ka shku në OPSH. Kam qenë dhe në OSHP, zhbllokone këtë çështje, jepja kujtë të duash veq shkolla e Pozheranit në të ndertohej. Edhe ne jemi ballafaqu me ankesa, veç ju keni ardh në pushtet tu thanë që kemi me i irregullu këto çështje dhe ndoshta revolta tash që e shfaq, se edhe Jakupi ka marrë kompetencë, ka thanë është qeveria ime, i ka marrë këto kompetencia që nuk është hiq e tijë, edhe mua më vjen keq këshilltarë, po asnijë infomratë nuk e ke për kuvend. Më shumë muj me të dhanë unë me dretjroeshën e DKA-së që kemi shkëmbi letra, çka na kanë thanë se kanë me të pru këshilltarët, ky është realitet dhe kjo temë nuk është si temë me ngrit dhe në përfundim me dalë grupet e këshilltarëve të kuvendit komunal të përfaqsum në Kuvendin e Komunës së Vitisë. Si shqetësim

muj me te përvosdorit eshte ngejoi me uajt me uekialat e periprojekte ne uekialat vashke me kryesuesin dhe grupet parlamentare. Ju po lypni a ka dëshmi. Ku po do dëshmi më të madhe se që 3 vjet nuk ka asnje baski të ngult dhe është lanë në mëshirë dhe tash operatori ndoshta i papërgjegjshëm po e ka pranu inxhinieri i ministrisë. Inxhinieri i ministrisë ka qenë me mua në takim, ka thanë në lidhjen e kontratës nuk kanë mujtë me u parapa do punë të cilat kanë me u kry, korizioni i kapriatave të palestrës sportive e disa tjera, dhe po duhet me bë dhe një vlerësim, e kanë bërë edhe këtë vlerësim dhe prap nuk ka asgjë. Premtimi që kemi me hy në 2022 ka përfundu 2024 nuk po fillon. Çështja e ngritjes së pozheranasve, këtë çështje ti po thu komuna me ngritë plan B. Po, ka mujt. Planin A me dashtë ministria nuk e kish qitë as në tender, kontrata burimore jeni mushë, pse nuk e keni bë njëjtë lidhjet e kontrates me nogocim. Unë i kam propozu kryeministrin, ka qenë aty, asnje fjali, plotë kam pas probleme të Vitisë, i kam thanë kryeministrin ndërtoje shkollen e Pozheranit. Shkolla e Pozheranit, nuk ka hije ty as neve si lokalitet me shkollën e parë të gjuhës shqipe, me Analfabet të Manastirit përfundoje, veproje kështu se nuk bëhet asgjë. Për 1 milion e 200 mijë kur nuk e kisha kontestu shumën, veç në të përfundon. Tash cila është, a është neglizhenca se nuk muj me thanë, është në raport parja, por janë disa çështje të cilat kërkojnë urgjencë dhe në urgjencë nuk ke çka ju friksohesh as ligjit as popullit. Ndesh në ta jadin voten ndesh jo, por nuk ka pas më mirë se me kap këtë me seriozitet prej vitit 2021 që jeni në pushtet dhe është dashtë me përfundu, por kjo ka tregu që është një neglizhencë jashtë mase. Nuk keni arsyë as me kritiku Qeverinë e Ramushit, Isa Mustafës, Avdullah Hotit në këtë drejtim të autostradës dhe këtë se ju mlon mos puna që nuk bënë as me përmend këtë çështje, dhe këshilltari që këkroj informatën, nuk kisha kërkua as informatë, nuk ke çka kërkon se vitet të kanë kalu, të ka ardh mandati edhe 8 muj hecë. Je tu lypë zgjedhje, nuk kemi çka diskutojm këtë çështje, por a duhet ne me bë përpjekje, e kujdo në të jetë iniciativa jam për me bë përpjekje maksimale e kujdo ne të jetë iniciativë, hajde e bëjmë një deligacion hetrogen, të përbërë nga subjektet politike që veprojnë në Komunën e Vitisë dhe shkojmë e inicojmë rastin, jam për atë. Me rëndesi është shkolla dhe shkollën e qes para stadiumit dhe para autostradës.

**z.Ramadan Deliu:** Unë e kam këtë pytjen e shujtave. Atë ditë kur është votu, ne nuk kem kundër, por nuk është në rregull, por ju thatë që ka komuna që e pagujnë. A jeni interesu cilat komuna e pagujnë këtë dhe në çfarë mënyre e paguajnë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Nuk e di, unë as nuk kam thanë atë ditë. Për këtë mbledhje kemi parapa këtë:

## R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytezim të pronës komunale (kioskave) përmes ankandit publik.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së palujshme komunale (kioskave) tek shtëpia e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në shfrytëzim afatshkurt prej 15 vite.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale përmes shprehjes së interesit në fshatin Budrikë të Komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë me numër protokolli 01-110/05-306, të datës 29.03.2024.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për financimin e shujtave ditore për shërbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të Komunës së Vitisë janar-dhjetor 2024, Vendimi me numër protokolli 01-110/05-308, të datës 29.03.2024.
6. Informatë nga manifestimi tradicional kulturo-sportiv "Flakadani i Karadakut" 2024.
7. Informatë nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për mblelljet pranverore 2024.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për rendin e ditës. Pasi që nuk ka për debat vazhdojmë me këtë rend të ditë. E qes në votim miratimin e rendit të ditës. Nga të gjithë u miratu rendi i ditës.

## 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Komitetit për Politikë dhe Financa

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet proceverbali? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës:

### 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytezim të pronës komunale (kioskave) përmes ankandit publik

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i Komunës:** Ju keni një propozim vendim të cilin e kishi dhe në seancën e kaluar, por të cilën nuk e patëm mirëkuptimin me hy në rend të ditës. Kësaj radhe e keni para jushë. Objekti apo kioska e cila është në kuadër të shtëpisë së kulutrës e cila ka qenë dhe në register, të cilën e kemi pranu që një prej pronave të jepen në shfrytëzim e keni sot para jush, andaj kërkoj edhe lejen e juaj që ky propozim vendim të shkon në Kuvend, se është në përputhje edhe me vendimin e juaj të aprovuar nga regjistri që e keni aprovu në dhjetor, që janë vendet e caktuara.

**z.Majlinda Shabani:** Te periudha prej 15 viteve: a ka qenë më herët e diskutume që me pas më pak vite apo kjo puna e 15 viteve që e keni parapa si kohëzgjatje afatshkurt qyshë është llogaritë, dhe a menoni që ndoshta është mirë me diskutu kohën e kohëzgjatjes?

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Është e drejtë e juaja. Ju e dini edhe më herët si kemi diskutu. Ky propozim vendim për herë të parë ju vjen, megjithatë kjo periudha në aspekt ligjor që e ndan në periudhën afatshkurt dhe afatgjatë, kjo ka shku në periudhën afatshkurt. Propozuesi e ka propozu deri në 15 vite, po megjithatë është e drejt ekskluzive e Kuvendit me i përcaktu vitet se sa.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Metrat katrok a janë ta caktuara vetëm ajo pjesa që është aty? Edhe unë mendoj që kjo kioska duhet me u hekë, sepse përkioska e kemi një irregullore edhe bjen në kundërshtim me irregullore. Pasi që nuk ka për me diskutu, e qes në votim për miratim. Me ngritje dore nga të gjithë u miratu kjo pikë e rendit të ditës që të shkon në kuvend.

Pika e tret e rendit të ditës:

### 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së palujshme komunale (kioskave) tek shtëpia e kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në shfrytëzim afatshkurt prej 15 viteve

Unë mendoj që ky propozim vendim duhet të përmirësohet e jo me ardh në kuvend subjekti i përcaktuar se, anëtarët e kuvendit janë të barabart e jo me përcaktu se nga cili subjekt politik, sepse çdo këshilltar ka të drejtë me qenë anëtar i komisionit.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Edhe unë pajtohem që me qenë pozitë e opozitë në komision.

**z.Majlinda Shabani:** Edhe unë mendoj që duhet me qenë pozitë e opozitë në këtë komision.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** E qes në votim për miratim këtë pikë që të shkon në kuvend. Me votat e të gjithve u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e katert e rendit të dites:

### 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale përmes shprehjës së Interesit në fshatin Budrikë të Komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë me numër protokolli 01-110/05-306, të datës 29.03.2024

Hapi debat për këtë pik të rendit të ditës.

**z.Ilir Zuka:** Tash komisioni që është fortmu është në rregull, po tash kemi pas me zbatu qet vendim që po e anulojmë. Tash duhet me pas vendim ne që për sa kohë me dhanë në shfrytëzim pronën.

**Z. Hasan Aliu, nënkyrytar i komunës.** Ligji është që dëshiron që të kthejë mësimdhënien e shkollave, porositë Albulenën dhe Fatlumin me kontaktu me ministri me na dhanë sqarime edhe në seancë tjeter del propozim vendimi si na jep instrukcionet ministria.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që edhe kjo pikë e rendit të ditës të shkon në kuvend? Me ngritje dore. Nga të gjithë u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e pestë e rendit të ditës

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për financimin e shujtave ditore për shërbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të Komunës së Vitisë janar-dhjetor 2024, Vendimi me numër protokolli 01-110/05-308, të datës 29.03.2024**

**z.Ilir Zuka:** Mënyrën si na ka ardh atë ditë u kanë përmu i ngutshëm. Masi ka kalu procedura, e dimi si ka kalu, e kam lutë kryesuesin që mos të bimi na pre, se është direkt që i prek ish kolegët, sepse kam qenë pjesë e institucioneve komunale dhe e di se sa janë shpenzimet, po mënyra se si na ka ardh, mënyra se si na ka qitë neve në atë pozitë ka qenë shumë e pahijshme. Unë kam kërkua me pas një dokument që jemi tu e votu. Shefi u grupit të juaj shumë në mënyrë arrogante u kthy se ti nuk ke votu me hi rend dite e ti nuk ki të drejtë me lypë. D.m.th kryesues, ne jemi përfaqësues të qytetarëve e nuk du me lujt me ndjenja të qytetarëve. Kryesus, të kam lutë edhe atë ditë që vendimet që janë të ndjeshme të bëhen me konsensus, se edhe unë jam me jav dhanë, sepse edhe unë 8 vite kam punu në institucion. Atë ditë mënyra si ka ardh propozimi ka qenë lloj tradhtije e tash duhet me dhanë dikush përgjegjësi morale, se kam kërkua atë ditë, se ne nuk po e votojmë. Po ju a jepni përgjegjësi morale nese e kthen ministria, sepse keni lujt me ndjenjat e shërbyesve civil, sepse ata dy muaj ditë kanë shpresu edhe u thirr Taulanti, shefi i grupit. Kemi ne përvoja tjerat, komuna kanë dhanë nuk u konsultu të jesh i bindur kryesues se çka është në të mirën e qytetarëve unë e kaloj edhe partinë, nuk jam që rri çka të më thotë partia.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** E shfuqizojmë edhe këtë vendim si të tjerët që i kemi shfuziqu.

**z.Hasan Aliu, nënkyrytar i komunës:** Unë e kam atë mendimin tim se, atë ditë edhe kryesuesi ka ra prej provimit, se ka ra pre e një shefi të vet, por megjithatë gjithçka duhet me qenë e argumentume, se atë ditë nëse një seancë mu ka dokë e zhugjdhje u kanë atë ditë, se kam bë përpjekje maksimale me e udhëzu cila është rruga ligjore, nuk ka bajraktarizëm me pi kafe në mëngjes edhe me thanë vetëm përgaditma se unë e qes. Më ka ardh shumë keq në radh të parë për këshilltarët që i kanë dhanë 15 vota që i ka marr, se e kam thanë jo rasisht neser i teket dikujt hajde parkun po ja falmi Hasanit me votu me shti rend dite. E njëjtë ka lujt si lider edhe kryesuesi ka ra. U dashke me stopu, u dashke me kërkua 10 minu pushim.

**z.Ilir Zuka:** Unë ja kam zan për të madhe edhe shefit të grupit të LDK-së, sepse tha po e votojmë kundër e ai nuk murr pjesë hiq në votim.

**z.Hasan Aliu, nënkyrytar i komunës:** Unë kam pas këshilltar nga partia ime që ka ardh ka thanë kemi gabu shumë ran. I kam thanë mos u merzit se nuk ki gabu.

**z.Zyrafete Rama:** Nuk është vendimi i parë që është kthy nënkyrytar, kemi edhe të tjera.

**z.Hasan Aliu, nënkyrytar i komunës:** Propozuesi i buxhetit është kryetari i komunës, aprovues jeni ju. Ju kam thanë atë ditë jashtë kësaj mundet me ardhë kryesuesi i kuvendit, përvèç që e ka votën e dyfisht, sepse përndryshe është i barabart me këshilltarët, por ky ka muj me thanë a e keshyrimi e ftojm Beratin e atë tjetrin e shikojmë a po ka mundësi buxhetore, e kemi bazë ligjore dhe përgadismi për seancën tjetër ama këtë se ka ba kryesuesi për aspekt politik të vetin që ka ra preh e Taulantit. Nuk kam qef me pa asnje lider të partive politike në atë nivel. Institucioni, komuna janë më të mëdhaj se qytetarët e jo kujt ti teket me thanë unë e baj këtë e baj atë, sepse ai ka punu pa logjikë, vetëm me e mujt nënkyretarin e kryetarin.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë po të thamë që dhjetra vendime i keni pru at hok, e keni kontrabandu që sa vite, ti e dinë edhe si kanë ardh e ku i kanë kthy ministria, të cilët i keni pru aty për aty. Njëjtë është si kjo që po e japim tek kioskat, kjo u kanë VC publike e ke bë trafikë, ja ki dhanë një personi e prapë për atë po del me ja dhanë qati. Kjo është hala ma kontrabandim, e shumë sene krej janë të planifikuara të kordinuara.

**z.Hasan Aliu, nënkyrytar i komunës:** Po të pyes: kush e ka dhanë byfenë te shtëpia e kulturës? Qysh e kemi gjetë. Kush e ka dhanë barnatorën në QKMF? Kush e ka dhanë “Arenën”? Prandaj, a u kanë një praktikë cilën e kemi stopu si pushtet.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Nuk u është kuvendi e ka pranishëm që vendimi për shtetin që kundërligjshëm. Unë atë ditë kam thanë që nuk kalon kjo kthehet negative.

**z.Ramadan Deliu:** Nuk është njëjtë si një vendim për një VC si për një trafikë si një vendim për punëtorët e Komunës. Neve na ka ardh keq prej punëtorëve të komunës. Unë vet kur kam shku te komuna më thanë qysh bre nuk naj votut neve për shujta.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Vetëm për një vendim e kam ditë që kthehet e ai ka qenë për Safet Rexhepin që e kam ditë që nuk kalon pa plan zhvillimor komunal.

**znj.Majlinda Shabani:** Unë mendoj që me ju pas ardh keq juve si subjek i LDK-së ish ba një planifikim adekuat prej fillimit kur është miratu buxheti. E para është arsyja pse e kane kthy se, shpenzimi i parë publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe sherbime nuk është e lejuar për pagesën e punonjësve. D.m.th ti këta e ki të ndalume, po nëse si komunë ti këtia komuna plotë që kanë ndjek praktika të tillë si p.sh.: pagesat për nenat lehona që është një politikë që e kanë bë shumë komuna. Po këtu është problemi, krej varet prej vullnetit që ka komuna. Tjetra ke e subvencionimit për çerdhe publike. Kjo është një politikë ku vet komuna shpreh gatishmërinë për me ba qat politikë, mirëpo ty ligji po ta ndalon me i shfrytëzu parat publike prej kategorisë që e cek në shkresë ministria. Nënkyetar, krej çka këtia që mujt me ba ti prej fillimi që në planifikim të buxhetit me i parapa qeto shujta që kanë qenë. Unë po thamë kërkesa që keto mu përfshi prej kategorisë së mallrave dhe shërbimeve ka qenë i gabuar, sepse këtu po cek shumë, mirëpo ty nuk ka një ligj që ta ndalon.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Lexohe atje ku ta ka ndalu u thirr në ligj tjetër, mirëpo nuk ka mujt bash me ta kthy, po nuk po do me ba praktikë këtë, sepse i del punë me krejt komunat.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Kontrata kolektive po e shofim tanë se qyshë po i dëmontruan komunat në përgjithësi, sepse nësë i qet buxhet komunës për këtë çështje ajo është çështje normale, po tash a e dini që 1 milion e 400 mijë këtë vit kemi pagu, edhe sistemi bashkëkohor ku ne punojmë kam përvojë, nuk i intereson çështja e udhëtimit dhe e shujtës. Kjo ka qenë prej politikave të komunizmit në shtetet e perëndimit a ta paguj rrugën dhe shujtën, jo.

**znj.Majlinda Shabani:** Varet prej komunës. Ne kemi pas raste të tjera, përshtembull për nënrat lehona është një diskutim që u kanë edhe prej momentit që unë nuk kam qenë asamblistë, po kanë qenë edhe grupe i grave, po asnjëhere nuk është marr përsipër ajo iniciativë, sepse komunat nuk po dojnë me prek buxhetit si në këtë rast tek shërbyesit civil e kemi pas rastin edhe tek tatimi në pronë, e kemi diskutu shumën prej 100 euro sa ka qenë temë diskutimi.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Pse po ngritë çështje të cilat janë të rregulluara më ligj. Unë e ti nuk jemi fajtor për çështjen e pagave, i ka përcaktu niveli qendror, kategorinë e veteranëve e ka rregullu niveli qendror, çështjen e lehonave e ka rregullu niveli qëndror.

**znj.Majlinda Shabani:** Çështjen e lehonave e kanë rregullu edhe komunat të cilat janë shtesë, mirëpo Komuna e Vitisë nuk po do me prek buxhetin e vet.

**z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës:** Shumë gabim e ke këtë që po e thu.

**z.Illir Zuka:** Atë që e thash në fillim duhet me pas unifikim e jo me u politizu, e cila u politizu nga Majlinda tanë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka për diskutim: a jeni që kjo pikë të shkon për në kuvend. Me votat e të gjithëve edhe kjo pikë shkon për në kuvend.

Pika e gjashte e rendit të ditës

## 6. Informatë Manifestimi Tradicional Kulturo-Sportiv "Flakadani i Karadakut 2024"

**z.Ismet Sejdiu nga Drejtoria për Kulturë:** Përshtendetje të nderuar të pranishëm! Sa u përket informatës, ky manifestim është tradicional në komunën tonë. Ka qenë edicioni i 23-të me radhë, të cilin e kemi organizuar dhe mbajtë manifestim, ky i cili ngërthen aktivitete nga më të ndryshmet kulturore dhe sportive, duke përfshirë hapjes solemne dhe dhezja e flakadanit me 24 mars. Kemi gara regionale të recituesve, orën e madhe lettrare. Me 26 mars e kemi edhe festivalin gjithëkombëtar të shoqërive dhe ansambleve kulturore artistike. Materialin e keni marr me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Na njofto për anën financiare.

**Z.İsmet Sejdiu nga Drejtoria për Kulturë. Kjo e vit kemi supozuar me pak ne kufizimin me viti paraprak.**  
Vitin 2023 ka qenë 26 mijë e 576.66 euro, kurse këtë vit jemi në 17 mijë e 691.18 euro. Janë mbajt të njëjtat aktivitete, po duhet të permendet se, tek akomodimi varësish prej numrit se sa marrin pjesë në akomudim.

**z.Ilir Zuka:** Një punë e mirë, vlera e shumës është më e vogël. Mirë është, po unë e kam një shqetësim këtu, më shumë ka njerëz që po jepin shfaqje se sa njerëz që shikojnë me pa. Kjo më shqetëson shumë. Unë kisha pas qef herav tjera me pas një informatë, sa njerëz për tri ditë e shikojnë këtë manifestim. Edhe du me cek një sen që, nuk po du me than në Kuvend përfaqësuesi i familjes së dëshmorëve ka qenë i padëshiruar në këtë manifestim. Është e dhimbësive kjo. Ju si drejtori duhet me marr përgjegjësinë, sepse është organizu nga drejtoria e jo familja. Unë e di që nga familja kanë thanë që është i padëshiruar, sepse ai i përfaqëson familjen e dëshmorëve.

**z.Ismet Sejdiu nga Drejtoria për Kulturë:** Sa i përket këtë që e shtroj Iliri, sa i përket audiences, është e vërtetë se madhështia e krej kësaj është audiencia, mirëpo prapë se prapë na jemi të kënaqur edhe me pjesëmarrjen e audiences, sepse thuhet se një shfaqje po ta shikoj dikush që është e kuption shfaqje, del shumë në rregull ana artistike, kurse sa i përket asaj të familjes së dëshmorëve ajo është çëshje e tyre jo e jona. Drejtoria i ka kry punët ashtu siç na ka obligu kuvendi komunal.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni ta votojmë këtë pikë për me dërgu në kuvend? Nga të gjithë u miratu kjo pikë që të shkon në kuvend.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

## 7. Informatë nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural për mblelljet pranverore 2024

A jeni që edhe kjo pikë të shkon në kuvend? Nga të gjithë u miratu edhe kjo pikë që të shkon në kuvend. Atëherë, pasi që nuk ka për debat me kaq shpall të myllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

---

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Bekim Azizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

Prantuar - Praktikojen Më/Deja	13-06-2024		
Nr.i organit Org.broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vlerësimi
02-	035/02-		882



Republika e Kosovës

Komuna e Vitisë

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës ( Gazeta zyrtare nr 28/2008), dhe nenit 50 shkronja I) të Statutit të Komunës së Vitisë me numër 013/491 të datës 21.04.2011 , Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë :

**PROPOZIM VENDIM  
PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE ( KAB ) TË KOMUNËS SË VITISË 2025-2027**

**Neni 1**

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal që të aprovoj Vendimin „ KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE ( KAB ) E KOMUNËS SË VITISË 2025-2027 “

Duke u bazuar në QARKOREN Buxhetore 2025/01 të datës 15.05.2024 nga Ministria e Financave Punës dhe Treansfereve ku paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2025-2027.

**Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është „KORNIZA AFATMESME BUXHETORE ( KAB ) E KOMUNËS SË VITISË 2025-2027 “ e hartuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim .

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

PROPOZUES : KRYETARI I KOMUNËS

Sokol Haliti





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

Prihvjeta - Prinajmo Mëlluan	13-06-2024	Vjeti
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetëse Prilog
02-	300/02-	883

KORNIZA  
AFAT MESME  
BUXHETORE (KAB) E  
KOMUNËS SË VITISË  
2025-2027

Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim

2024

# **Përbajtja**

I. Hyrje

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

III. Korniza Fiskale

- 3.1 Korniza makroekonomike komunale
- 3.2 Tendencia e të hyrave komunale dhe parashikimet 2025-2027
- 3.3 Politikat e reja
- 3.4 Tendencia e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2025-2027

IV Korniza e Shpenzimeve


## I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, është një dokument i cili përgatitet nga zyrtarët e administratës komunale dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm, përmes të cilëve, objektivat prioritare të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2025/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027 (KAB 2025-2027) paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2025. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë të bazuar për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Korniza Afatmesme Buxhetore do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritare të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së drejtë të burimeve komunale për periudhën 2025-2027. Janë katër faza të përbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtëme:



## **II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore**

Komuna e Vitisë shtrihet në pjesën Juglindore të Kosovës, rajoni i Anamoravës, përafërsisht 40 km në jug të Prishtinës. Kufizohet me pesë (5) komuna tjera (Gjilanin, Ferizajn, Kaçanikun Kllokotin e Parteshin dhe në jug me Republikën e Maqedonisë. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Lumi "Morava" e Binçës kalon përmes luginës qendrore të komunës, ku krijon kushte më të favorshme për aktivitete bujqësore. Vitia i takon zonës me klimë të mesme kontinentale, ku lartësia mbidetare nuk i kalon mbi 1400 metra.

Komuna e Vitisë ka gjithsej 39 vendbanime. Prej tyre janë 38 fshatra dhe qyteti i Vitisë. Sipas rezultateve preliminare të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Vitisë ka 46,951 banorë rezidentë dhe 13604 banorë jashtë Kosovës, të organizuar në 7519 ekonomi familjare. 69% nga popullsia del se janë mbi moshën 15 vjeçare. Nga viti 2011 deri ne vitin 2019 popullsia e Komunës së Vitisë ka tendenca të rritjes. Sipas përkatësisë gjinore, përbërja meshkuj femra është 49.60% femra dhe 50.40% meshkuj. Në raport të popullsisë qendër dhe pjesëve rurale, përqindja e popullsisë që jetojnë në qytet sillet rrith 10% dhe 90% në pjesët rurale (fshatra).


Sipas përbërjes etnike, popullsia në Komunën e Vitisë ka këtë statistikë: gjithsej janë 99.3% janë shqiptar, ndërsa minoritetet tjera janë serb me 113 serb, 25 boshnjak, 14 ashkali, 12 rom, 7 goran, 4 turq dhe të tjerë janë 143 banor, që në përqindje i bie 0.7 % minoritete tjera jo shqiptare. Sa i përket natalitetit dhe mortalitetit, gjatë vitit 2019 numri i lindjeve (nataliteti) është 696 lindje dhe 254 vdekje (mortaliteti).

Migrimi i popullsisë vitiasë është përshkruar me trend të rritjes si nga brenda ashtu edhe nga jashtë shtetit. Sot konsiderohet se përqindja e migrimit të jashtëm të popullsisë është 13180 banorë apo 28% e numrit të përgjithshëm të banorëve, që jetojnë, veprojnë e punojnë jashtë Kosovës, ndërsa migrimi i brendshëm është i theksuar.

Sa i përket moshës së popullsisë, kryesisht dominon mosha 0 - 19 vjeç, apo në përqindje 41.10%; mosha 20 - 64 vjet, apo 52.50%; dhe mosha mbi 65 vjeç, 6.40%.

Në aspektin gjeografik Vitia është e vendosur në rrugën rjonale që lidhë Gjilanin dhe Ferizajn, ndërsa lumi "Morava" kalon nëpër komunë, duke krijuar kushte të mira për bujqësi.

## Komuna e Vitisë



Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Vitisë i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna sic janë:

1. Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025-2027 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore Komunale 2025/01 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Strategja për Zhvillim Ekonomik Lokal 2022 - 2026
3. Plani zhvillimor urban – Viti 2010-2015+

*Vizioni i Komunës për tri vitet e ardhshme është një vend me plan të zhvilluar komunal dhe urban, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, dhe shërbime efikase e kualitative, i integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër me kultura bujqësore, industri përpunuuese ( drurit, metaleve ), e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe krijimit të kushteve më të mira të jetesës për të gjithë qytetarët e saj pa dallime në baza gjinore për të gjithë qytetarët e saj (gra, burra, vajza dhe djem), ose promovimin e barazise gjinore .*

*Djep kulturor i shkollës shqipe, urë e zhvillimit të qëndrueshëm, modern, të fuqishëm, funksional me të gjitha përbajtjet, komunë policentrike, atraktive për të jetuar dhe punuar, partneritetet publiko private do të determinojnë shërbimet cilësore, aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turizëm në zhvillim, Komuna e Vitisë do jetë me të gjitha resurset atraktive për investime dhe ndërmarrësi, sidomos në industrinë përpunuuese, agrobiznes, turizëm kulturor e rekreativ, me theks të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm, modern, të fuqishëm, funksional me të gjitha përbajtjet, qytet kompaktë, atraktiv për të jetuar dhe punuar, promovues i partneritetet publiko private me shërbime cilësore, aktivitete ekonomike e mirëqenie në zhvillim, me rolin dhe identitetin e fuqizuar.*

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësira e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përbushjes së këtyre dy atributave binjake prioritet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në pesë prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Nga këto pesë prioritete kanë të bëjnë me realizimin e objektivave dhe kontribuon në zhvillimin e shërbimeve më të mira komunale për qytetarët e Komunës së Vitisë:

## 1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë (me prioritet fuqizimin ekonomik të grave)

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimit të standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe permirësim, bursa për student/e, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë
